



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

Nr _____ DATË _____._____.2026

“PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK 2025”

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____ shqyrtoi materialin e paraqitur “Për miratimin e buxhetit faktik 2025”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, ‘Për menaxhimin financiar dhe kontrollin’ i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore’, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtitë e pushtetit vendor”, Udhëzimit Nr 8, datë 09.03.2018 ‘Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme’ i ndryshuar, si dhe në mbështetje të VKB nr 86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e programit afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025”.

V E N D O S I

- 1.Të miratoj buxhetin faktik 2025 në Bashkinë Gjirokastër, sipas dokumentit bashkëngjitur vendimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Gjirokastër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita Isaraj

Sekretar i Këshillit

Bexhet Baxhella



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI

P/VENDIM

Nr. __ date __. __. 2026.

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE
PËR MUAJIN QESHOR 01-30.06.2026.**

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit Nr 85 datë 10.02.2021, si dhe bazuar në Udhëzimi nr.4 datë 17.02.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore” VKB nr. 101 datë, 22.12.2025 për “Për Miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026” është miratuar fond “Ndihma Ekonomike” me fond limit 3.000.000 lekë/vit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë;

VENDOSI:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Qeshor 2026, 51 individë/ familje me fond 149,852 lekë.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

P/ VENDIM

Nr. ____ datë ____ . ____ .2026

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMI E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK- NDIHMËN EKONOMIKE DERI NE 6% PËR MUAJIN QESHOR 01-30.06.2026.

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597, date 04.09.2019 për “Për Përcaktimin e Procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, me propozim të kryetarit të bashkisë Gjirokastrë;

VENDOSI:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Qeshor 2026, 6 (gjashtë), individë/familje** me fond **19,957 lekë**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT
Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

P/ VENDIM

Nr. ____ datë ____ . ____ .2026

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL VENDOR TË BASHKISË GJIROKASTËR PËR PERIUDHËN 2026–2029”.

Këshilli Bashkiak Gjirokastrë, në mbështetje të nenit 9, nenit 24 pika 1, nenit 54 shkronja “k” dhe nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”; Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030; si dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Social dhe Shëndetësor të Bashkisë Gjirokastrë,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Planin Social Vendor të Bashkisë Gjirokastrë për periudhën 2026–2029”, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Agjencia e Shërbimit Social dhe Shëndetësor, në bashkëpunim me drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë Gjirokastrë, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin Social Vendor.
3. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të parashikojë fondet përkatëse në Programin Buxhetor Afatmesëm dhe në buxhetet vjetore, në përputhje me planin e veprimit dhe burimet financiare të identifikuar në dokument.
4. Strukturat përgjegjëse të Bashkisë Gjirokastrë të raportojnë periodikisht mbi ecurinë e zbatimit të Planit Social Vendor, sipas mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të përcaktuara në dokument.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

P/ VENDIM

Nr. ____ datë ____ . ____ .2026

PËR “MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2026–2030”.

Në mbështetje të nenit 24, pika 1 dhe nenit 54, pika “k” të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 64/2025, datë 06.11.2025 “Për barazinë gjinore”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.06.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe planit të saj të veprimit”; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjit nr. 11/2026 “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”; Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar; Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, të nënshkruar nga Bashkia Gjirokastrë; si dhe dokumentit “Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030”, Këshilli Bashkiak Gjirokastrë,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2030, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Të ngarkojë të gjitha drejtoritë, strukturat administrative dhe institucionet në varësi të Bashkisë Gjirokastrë për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në plan.
3. Drejtoria e Financës të parashikojë fondet përkatëse në programet buxhetore afatmesme dhe vjetore, në përputhje me objektivat e planit.
4. Agjencia e Shërbimit Social dhe Shëndetësor, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të koordinojë monitorimin dhe raportimin periodik të zbatimit të planit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

P/ VENDIM

Nr. _____, datë ____./____./2026

PËR

DHËNIEN E TITULLIT “ QYTETAR NDERI” PËR Z. SPIRO MASTORA (pas vdekjes)

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit", Ligji nr 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit, V.K.M Nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit”, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, në mbledhjen e datës ____/____/2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e titullit “ Qytetar Nderi” për Z. Spiro Mastora (pas vdekjes) me motivacionin :
“Për shërbime të shquara për qytetin e Gjirokastrës në promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, traditës, historisë, turizmit, personaliteteve të shquara brenda dhe jashtë vendit”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Gjirokastrë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”

KRYETAR I KËSHILLIT

MERITA ISARAJ



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

P/VENDIM

Nr. _____, Datë ____/____/____

“Për një ndryshim në Nenin 5 ,Pika 2 të Rregullores të Miratuar me vendimin Nr.39, Datë 31/05/2022 për Miratimin e Rregullores së Funksionimit të hapësirave publike në Zonën e Pazarit Karakteristik”

Këshilli I Bashkisë në mbledhjen e dates ____/____/____, pasi analizoi materialin e relatuar nga Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike, në mbështetje të Ligjit Nr.9632 dt 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar); Ligji Nr.99/20 Datë 19.05.2008 për procedura tatimore në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore të Ligjit Nr107/14, Datë 31.07.2014 për Planifikimin dhe ndryshimin e Territorit (i ndryshuar), Ligjit 82/24, Datë 15.05.1997 për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.10.96, Datë 28.12.2015 për Miratimin e Rregullave, Kushteve dhe Procedurave për përdorimin dhe Menaxhimin e Hapësirës Publike

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshim në Nenin 5 ,Pika 2 të Rregullores së Miratuar me vendimin Nr.39, Datë 31/05/2022 për “Miratimin e Rregullores së Funksionimit të hapësirave publike në Zonën e Pazarit Karakteristik”
2. Oraret te ndryshohen duke u zgjatur me dy ore dhe konkretisht nga ora 12:00 deri ne oren 02:00 per rrugen e Zejtareve dhe rrugen Peço Kirka dhe nga 16:00, ne 02:00 per rrugen Gjin Zenebishti, Alqi Kondi, Gjin Bue Shpata dhe Ismail Kadare.
3. Per zbatimin e ketij Vendimi ngarkohet Bashkia Gjirokaster.
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEKRETAR I KESHILLIT

Bexhet Baxhella

SEKRETAR I KESHILLIT

Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

P/ VENDIM

Nr. _____, datë ____./____./2026

PËR

**“VENDOSJEN E Z. MAKSIM GORICI NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE ‘SHPRESA E
JETËS’, GJIROKASTËR”**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 24, dhe të ligjit Nr. 121, datë 21.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në VKM. Nr.518, datë 04.09.2018 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Komunitar e Rezidencial, Kriteret, Procedurat për përfitimet e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale dhe përfituesit e shërbimit të organizuar”. Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, në mbledhjen e datës ____/____/2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për vendosjen e z. **Maksim Gorici** në Shtëpinë e të Moshuarve “Shpresa e Jetës”, Gjirokastrë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, Shtëpia e të Moshuarve “Shpresa e Jetës”.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT

MERITA ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

P/VENDIM

NR____, DATË _____.____.2026

**“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2027-2029”**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____ pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për miratimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njësitë e pushtetit vendor”, Udhëzimit nr 7, datë 27.02.2026, ‘Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029’, si dhe në mbështetje të VKB nr 93, datë 22.12.2025 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027”.

V E N D O S I

1. Të miratojë dokumentin e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Gjirokastrë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT
Merita Isaraj**

**Sekretar i Këshillit
Bexhet Baxhella**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

NR _____, DATË _____

“Për një saktësim në Vendimin Nr 06 datë 28.01.2026 “Për një shtesë në VKB nr.101 datë 22.12.2025 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit vjetor 2026” për projektin “CERV dhe CROSS”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____ shqyrtoi materialin e paraqitur “Për një saktësim në Vendimin Nr 06 datë 28.01.2026 “Për një shtesë në VKB nr.101 datë 22.12.2025 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit vjetor 2026” për projektin “CERV dhe CROSS”” Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për fianancat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 10, datë 12.07.2024 “Për rregjistrimin, përdorimin, rakordin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe VKB nr.101 datë 22.12.2025 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit vjetor 2026” për projektin “”

V E N D O S I:

1. Të miratojë saktësimin si më poshtë:

Ishte:

Gr.00 Tit. AA115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P360XXX workshop, seminare dhe konferenca (workshops/seminar/and conferences) në vlerën 1,928,800 ALL

Bëhet:

Gr.00 Tit. AA115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P413AAN workshop, seminare dhe konferenca (workshops/seminar/and conferences) në vlerën 1,928,800 ALL

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

Sekretari i Këshillit

Bexhet Baxhella



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

**KËSHILLI BASHKIAK
P/VENDIM**

NR _____, DATË _____

“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 101, DATË 22.12.2025 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT AFATMESËM 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026” PËR SHPËRNDARJEN E FONDEVE TË TRASHËGUARA”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____ pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për një shtesë në vendimin nr 101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” për shpërndarjen e fondeve të trashëguara”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09, datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të VKB-së nr 101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesat në vendimin nr 101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026” sipas aneksit nr.1, bashkëngjitur vendimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

Sekretar i Këshillit

Bexhet Baxhella